



Република Северна Македонија  
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ  
Republika e Maqedonisë së Veriut  
AVOKATI I POPULLIT  
Republic of North Macedonia  
O M B U D S M A N

Më datën 07.11. 2022, Mekanizmi parandalues nacional (MPN) realizoi një vizitë të rregullt të paparalajmëruar në Qendrën e pranimit të të huajve në Gazi Babë. Vizita filloi në orën 10:00, ndërsa përfundoi në orën 14:30 (me kohëzgjatje prej 4 orë e 30 minuta).

Qëllimi i kësaj vizite, konform Protokollit fakultativ të Konventës kundër torturës dhe trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese ose ndëshkuese, është të identifikojë rreziqet për parandalimin e torturës ose llojeve të tjera të trajtimit mizor, çnjerëzor ose degradues, ose ndëshkues.

Gjatë vizitave në Qendrën transitore janë shqyrtuar:

- kushtet materiale në vendet e akomodimit dhe ndalimit,
- sjellja e zyrtarëve në qendra,
- të dhënat e personave të akomoduar/ndaluar në qendra,
- vende të tjera (dhoma pune dhe dhoma të tjera ndihmëse si kuzhina, tualetet, etj.).

Avokati i Popullit si Mekanizëm parandalues nacional i kushton vëmendje të veçantë dhe monitoron vazhdimisht trajtimin e migrantëve të parregullt, si dhe të të huajve pa qëndrim të ligjshëm në territorin e shtetit, si dhe vendet ku organet kompetente i akomodojnë dhe i ndalojnë ata.

Qendra është nën juridiksion të Ministrisë së punëve të brendshme, të cilët janë përgjegjës për sigurinë në të. Gjatë vizitës konstatuam se mbrojtja primare mjekësore ofrohet nga një mjek i Kryqit të Kuq i cili vjen tri herë në javë dhe kujdeset për gjendjen shëndetësore të personave të vendosur në Qendër.

Personat e ndaluar në këtë Qendër janë të ekspozuar ndaj cenueshmërisë së veçantë për sa i përket shëndetit të tyre mendor dhe të përgjithshëm fizik për shkak të mungesës së informacioneve të sakta për kohëzgjatjen e qëndrimit të tyre në Qendër, si dhe për kushtet në të cilat ata qëndrojnë pa aktivitete të rëndësishme sociale- edukative dhe profesione të tjera thelbësore.

Në Qendër janë të pranishme edhe një sërë organizatash joqeveritare të cilat ndihmojnë funksionimin e saj me mbështetje në ushqim, veshmbathje, por edhe ndihmë juridike.

Pas vizitës së realizuar, Mekanizmi parandalues nacional do të përgatisë një raport të posaçëm në të cilin do të konstatojë situatat pozitive dhe negative dhe do t'u japë rekomandime përkatëse organeve relevante me qëllim të eliminimit të mangësive.